

SOKOL GJERMENI**KONCEPTI KOMB-SHTET NË LIDHJEN E PRIZRENIT***

Procesi i formimit të kombeve dhe shteteve moderne që kishte ndodhur dhe po vijonte të ndodhte në Evropë po pasohej edhe nga popujt e Ballkanit. Ky realitet pasqyrohet në zhvillimin e modeleve të reja të popujve ballkanik drejt rendit të shoqërive moderne, në transformimet e jetës së brendshme politike, ekonomike, kulturore dhe sociale. Gjithashtu reflektohet dhe në bindjen e elitave përfaqësuese të këtyre entiteve duke ia nënshtruar organizimin e jetës, bazës së tipologjisë teorike konceptuale dhe filozofisë së ideve perëndimore që udhëhiqte sistemin ndërkombëtar të politikbërjes, i cili rendte drejt ndryshimit. Ngjarjet e viteve 1878 – 1881 po i vendosnin shqiptarët përballë një transformimi historik, ndaj të cilit ata duhej të zgjidhnin të përfshiheshin ose jo në të. Ideja e kombit dhe shtetit do filloj të trokas në ndërgjegjen e tyre.

Interesi dhe vëmendja e atdhetarëve që në fillim të përgatitjes dhe gjatë ekzistencës së Lidhjes së Prizrenit veç të tjerash u përqendrua te zhvillimi i konceptit të kombit dhe të shtetit, duke pasur si qëllim përpunimin dhe materializimin e tyre te populli. Synimi ynë është të evidentojmë ecurinë e formësimit të nocionit të komb-shtetit në mendimin politik të kësaj lëvizje kombëtare me të gjithë specifikat që e karakterizojnë. Që në vigjilje të themelimit të Lidhjes Shqiptare, konceptet e kombit dhe të shteti fillojnë të jenë pjesë e ligjëritimit politik të intelektualëve. Në fillim të pranverës së vitit 1877, një numër i vogël shqiptarësh të shqetësuar për rreziqet që i kanoseshin Perandorisë Otomane, u takuan në fshehtësi, nën udhëheqjen e Abdyl bej Frashërit. Me sa duket, ata hartuan një program për autonominë administrative të Shqipërisë si një mjet për të ruajtur të gjitha tokat e banuara nga shqiptarët. Ide të tjera për reformën përfshinin edhe punësimin e zyrtarëve shqiptarë, hapjen e shkollave në gjuhën shqipe dhe kufizimin e shërbimit ushtarak prej shqiptarëve për ta kryer atë vetëm në territorin shqiptar. Ky program pasqyronte shfaqjen e shqiptarizmit si rrymë politike. Synimi i tij politik ishte të krijohej një qeveri autonome për Shqipërinë. Programi ishte projektuar për të ruajtur

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Kombëtare “Shqiptarët përballë sfidave të bashkimit dhe të lirisë”, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë, 13 qershor 2008.

dhe zhvilluar një identitet shqiptar që i kapërcente interesat krahinore¹. Futja në zbatim e këtyre reformave do të krijonte një administratë autonome në Shqipëri, në duart e shqiptarëve, diçka që sulltan Abdyl Hamiti nuk ishte i përgatitur ta bënte. Në kërkesën për një provincë të vetme autonome të Shqipërisë, shqiptarët mund të mbështeteshin tek shembujt e një principate autonome dhe një krahine autonome të Rumelisë lindore, të krijuar nga traktati i Berlinit. Ata arsyetonin duke shtruar pyetjen: përse shqiptarët duhet të meritojnë më pak²? Në mbledhjen që u mbajt në Janinë u vendos që t'i dërgohej një memorandum qeverisë osmane, ku t'i bëhej e ditur se nëse shteti osman nuk do të ishte në gjendje t'i mbronte tokat shqiptare, atëherë do të krijohesh një administratë autonome shqiptare dhe këto toka do të mbroheshin nga vet shqiptarët³.

A përbënte populli shqiptar një komb? Në qoftë se ai nuk quhej komb çfarë kushtesh duhet të merreshin në konsideratë nga inteligjencia brenda dhe jashtë Shqipërisë? Në bazë të teorive që studiojnë cilësitë e kombit në praktikë ka pasur vetëm tre kritere që i lejonin një popull të klasifikohesh pa mëdyshje si komb. *Kriteri i parë* ishte lidhja e tij historike me një komb ekzistues ose me një që kishte pasur një të kaluar të afërt dhe mjaft të gjatë. *Kriteri i dytë* ishte ekzistenca e një elite kulturore të ngulitur prej kohësh, që zotëronte një gjuhë amtare të shkruar kombëtare, si për letërsinë dhe administratën. Ndërsa *kriteri i tretë* ishte aftësia për të pushtuar. Shqiptarët nuk i përmbushnin këto kritere. Por ata mund ti grupojmë me të tjerët ku sipas Hobsbaum-it zgjidhja më e sigurt ishte që ata të bënin pjesë në ndonjë tërësi politike (në rastin në fjalë ata ishin nënshkretat të Perandorisë Osmane - S. Gj.) që, sipas standardeve të shekullit të nëntëmbëdhjetë, ishte e vjetruar dhe e dënuar nga historia e përparimi⁴. Për të arritur ndërtimin e një shteti kombëtar shqiptar nuk ishte e lehtë. Rruga që duhej të ndiqej ishte ajo që populli të mbërrinte në stadin e kombit.

“Kombi si përparim” ka qenë si rrjedhim logjik asimilimi⁵. Inteligjencia shqiptare kërkonte të realizonte pikërisht këtë, asimilimin e hierarkisë së normave shoqërore të përkushtimit, të besnikërisë, të institucioneve të së kaluarës, të besimit dhe të afeksionit që individit dhe populli kishin ndaj familjes, fisit, prijësit, krahinës, duke e orientuar ndërgjegjen e tyre për të ndryshuar format e sjelljes psiko-sociale me qëllim që këtej e tutje të

¹ George Gawrych, *Gjysmëhëna dhe Shqiponja*, Tiranë: “Bota Shqiptare”, 2007, f. 59-60.

² *Po aty*, f. 77.

³ Nuray Bozborra, *Shqiptarët dhe nacionalizimi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Tiranë: “Dituria & ShLK”, 2002, f. 167.

⁴ Erik Hobsbaum, *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780*, Tiranë: “Toena & Fondacioni Soros”, 1996, f. 37-38.

⁵ *Po aty*, f. 39.

besëlidheshin me “të shenjtin”, kombin. Udhëheqësit nacionalist shqiptar e kishin kuptuar mirë pozitën delikate të Perandorisë Osmane në Ballkan ku përplaseshin interesat e Fuqive të Mëdha dhe njëkohësisht e kishin kuptuar se nga një copëtim përfundimtar që mund t’i bëhej kësaj perandorie, shqiptarët do të ishin më të humburit. Në fakt copëtimi i Shqipërisë shihej si i pashmangshëm, pasi ajo nuk gëzonte ndonjë unitet, i çfarëdo lloji qoftë ai⁶.

Në një seri artikujsh të botuar gjatë muajve prill e maj në organin austriak “Messenger de Vienne”, Abdyl Frashëri argumentonte para opinionit publik evropian të drejtat politike që i takonin popullit shqiptar si një nga kombet më të lashta të Evropës, me gjuhë, me territor, me kulturë, me ndërgjegje dhe me histori të përbashkët mijëra vjeçare⁷. Që në fillim kërkesat kryesore të Lidhjes Shqiptare ishin njohja e kombit shqiptar dhe bashkimi i tokave të Shqipërisë në një shtet kombëtar⁸. Në shqyrtimin e bërë në dokumentin (e Karanames) në lidhje me kërkesat që parashtronte, ajo kishte një karakter krahinor. Ai nuk thoshte asgjë për reforma, shkolla, autonomi, asgjë përveçse një bashkimi të tokave shqiptare në një vilajet të vetëm⁹. Përveç kësaj aty flitet për natyrën e Lidhjes, për mënyrën e funksionimit të saj, si dhe për raportet që do të kishte me Portën e Lartë¹⁰. Ajo që vihet re është se në ligjet e para të Lidhjes, e drejta dhe shtrëngimi i karakterizojnë¹¹ këto ligje. Parimet e kombit dhe të shtetit, intelektualët i trajtuan me shumë rëndësi në veprimtarinë e tyre, pranë kancelarive dhe personaliteteve të kohës me të cilët ata patën kontakte, pasi ato kishin një rol mbizotërues në vendimmarrjen e fateve të popujve.

Në memorandumun që iu dërgua kryeministrit anglez, më 13 qershor 1878 përdoren argumente të mbështetura kryesisht mbi parimin e kombësisë, ku territori dhe gjuha në këtë dokument konsideroheshin me të drejtë si tipare themelore të kombësisë¹² së shqiptarëve. Në dokumentet e para të saj programatike, koncepti i territorit dhe i rolit të tij në konsolidimin kombëtar, në organizimin politik del si një kusht i domosdoshëm për ruajtjen e kombësisë shqiptare. Ky koncept i territorit u shikua i lidhur ngushtë me parimin e kombësisë¹³. Nga fundi i muajit korrik 1878, si pjesë e kërkesave të shqiptarëve për sigurimin e të drejtave avancoi më shumë ndër të tjera dhe objektivi për

⁶ N. Bozbor, *vep. e përm.*, f. 171.

⁷ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Tiranë: “Toena”, 2002, f. 152.

⁸ Kristaq Prifti, “Aspekte të luftës për krijimin e shtetit kombëtar shqiptar”, në: *Studime historike*, XXXIII, nr. 4, Tiranë: 1979, f. 88.

⁹ G. Gawrych, *vep. e përm.*, f. 70.

¹⁰ Më gjerësisht shih: Xhafer Belegu, *Lidhja e Prizrenit e veprimet e sajë 1878-1881*, Tiranë: 1939, f. 31-33.

¹¹ *Drejtësia Popullore*, nr. 2, Tiranë: 1979, f. 81.

¹² Shyqyri Ballvora, “Koncepti i territorit i Lidhjes Shqiptare të themeluar në Prizren”, në: *Studime historike*, nr. 2, Tiranë: 1978, f. 10.

¹³ *Po aty*, f. 11-12.

njohjen e kombësisë¹⁴. Një ndër çështjet për të cilën kërkohej pjekuri politike ishte se çfarë kriteresh duhej të përzgjidheshin, që do shërbenin për të identifikuar qartësisht komb-shtetin e shqiptarëve në atë mënyrë që të ishte mjaft bindës së pari për vet këta, për Perandorinë Osmane dhe për Fuqitë e Mëdha. Konceptimi i kombit bashkudhëtoi njëherësh me një realitet të ri që po ndodhte në Perandorinë Otomane, ku ndarja administrative e popullsisë sipas kriterit të vetidentifikimit gjuhësor e kulturor kishte zëvendësuar normën e vjetër, atë të sistemit të mileteve. Normë, e cila për shekuj me radhë përbënte thelbin e sundimit otoman si një perandori mbikombëtare, ashtu siç shvleftësoi edhe vetë bazën e unitetit islamik apo unitetit ortodoks që kishte qenë tipar i deriatëhershëm¹⁵ i kësaj Perandorie.

Nisur nga përmbajtja e formulimit të paraqitjes si një komb i veçantë, elita shqiptare iu referua gjuhës amtare dhe territorit në të cilin jetonte ky popull. Gjuha dhe territori nuk ishin të rastësishëm, të dy ishin përbërës objektiv, të cilët u përdorën nga udhëheqësit për të përcaktuar kufijtë e komunitetit etnik të kombit e të shtetit që donin të krijonin. Në kushtet kur faktorët e tjerë që zakonisht përbëjnë bazën e krijimit të një identiteti kolektiv ishin problematikë, elementi që kishte potencialin të luante rolin e një faktori kohezioni mbetej gjuha¹⁶. Në memorandumet dhe protestat shquhet një karakteristikë e përbashkët, sepse hartuesit e tyre niseshin nga koncepti i ekzistencës së kombit shqiptar, i vetë Shqipërisë si atdheu i përbashkët i shqiptarëve, si njësi territoriale e përcaktuar dhe e njohur nga tërë shqiptarët mysliman, katolik dhe ortodoks¹⁷. Përcaktimi i kombit ka lidhje e ndikohet dhe nga sistemi i qeverisjes së shtetit. Ky tipar vërtetohet nga projekti që iu paraqit Valiut të Janinës dhe të Kosovës më 24 korrik 1878, ku insistohet që të zbatohen reformat e nevojshme në Shqipëri para çdo vendi tjetër¹⁸. Në muajin nëntor 1878, krerët e jugut miratuan zyrtarisht programin e bashkimit të vilajeteve në Frashër, nën drejtimin e Abdyl Frashërit. Pas kësaj, organizata veriore shqiptare e pranoi parimin e unitetit territorial të autonomisë, por të dy grupet nuk ranë në ujdi në hollësitat e kohës së zbatimit¹⁹.

Shumë udhëheqës verior në fillim ishin ngurrues në kërkimin e autonomisë dhe të drejtave kulturore. Në vend të tyre, ata kërkonin qëllime të kufizuara të tilla, si mbajtja e tokave të tyre brenda perandorisë dhe ruajtjen e

¹⁴ *Po aty*, f. 14.

¹⁵ Piro Misha, "Fenomeni nacionalizëm dhe kriza shqiptare", në: *Përpyjekja*, Viti VI, nr. 5-6, Tiranë: botim i Qendrës "Përpyjekja", 1999, f. 17-18.

¹⁶ *Po aty*, f. 21.

¹⁷ K. Prifti, *art. i cit.*, f. 95.

¹⁸ Sh. Ballvora, *art. i cit.*, f. 14.

¹⁹ Charles & Barbara Jelavich, *Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit, 1804-1920*, Tiranë: "Dituria", 2004, f. 208.

privilegjeve të tyre²⁰. Nocionit të komb-shtetit të shqiptarëve i duhej të përballej dhe të konkuronte njëkohësisht me konceptet e nacionalizmave të fqinjëve të vet. Në të njëjtën kohë, ashtu si në çdo proces kombformues, edhe shqiptarët kishin nevojë të provonin legjitimitetin e vazhdimësisë së tyre historike, që në kontekstin ballkanik donte të thoshte të provonin se ata ishin prej shekujsh autoktonë (mundësisht më gjatë se fqinjët) në tokat ku jetonin, çka u nevojitej, po ashtu për të përballuar pretendimet e fqinjëve, që duke u mbështetur në një propagandë tepër agresive jo vetëm mohonin ekzistencën e popullit shqiptar, por në zellin nationalist shkonin deri në absurditete, si rrekja e një ish kryeministri serb Gjeorgjeviç, i cili kërkonte t'ia mbushte mendjen botës se shqiptarët ishin njerëz me bisht²¹.

Që të realizoje bashkimin e shqiptarëve rreth konceptit të kombit dhe të shtetit nuk ishte një nismë që mund të përmbushej pa mundim. Për t'i bashkuar ata, kërkoheshin ose ndonjë ndikim i jashtëm, ose një përgatitje e kujdesshme, ose të dyja bashkë²². Politika që kishte ndjekur Porta e Lartë gjatë katër shekujve e kishte copëtuar dhe penguar në mënyrë kaq të efektshme unitetin kombëtar, sa që nevojitej një ndikim i jashtëm për të ribashkuar fiset e zemëruara me bashkatdhetarët e tyre në fusha dhe për t'i shndërruar patriotizmin e fshehur dhe zemërimin e tyre të zjarrtë e të pafuqishëm në një qëndresë kombëtare aktive. Këtë ndikim të jashtëm do ta ushtronte vetë Porta, e cila qe e para që i bashkoi shqiptarët në emër të atdhetarisë²³. Atdhetarët përdorën dhe kriteret e tjera. Elementët e përbashkët që njerëzit kanë me njëri-tjetrin janë një element që i ndihmon ata të ndjejnë vetveten dhe përkatësinë ndaj njëri-tjetrit për të krijuar një komb. Këto ngjashmëri mund të jenë karakteristika demografike (të tilla, si: gjuha, raca dhe feja), ose mund të jenë kultura e përbashkët, ose përvojat historike²⁴. Kur karakteristika të tilla shfaqen fuqishëm, formimi i kombit pararend krijimin e shtetit. Të ndjehesh një bashkësi. Perceptimi këtu është kryesori²⁵. U përpoqën që shqiptarët jo vetëm të ndjeheshin si të tillë, por që edhe të perceptoheshin nga të tjerët si një entitet i ndryshëm. Dëshira për të qenë politikisht i ndarë²⁶ nga shteti, pjesë e të cilit një komb është. Koncepti “ne” dhe “ata”. Dhe nuk ka mjet më të efektshëm për t'i lidhur në një tërësi të vetme dasitë e një populli të shqetësuar se sa bashkimi

²⁰ G. Gawrych, *vep. e përm.*, f. 105.

²¹ P. Misha, *art. i cit.*, f. 24.

²² Joseph Swire, *Shqipëria ngritja e një mbretërie*, Tiranë: “Dituria”, 2005, f. 56.

²³ *Po aty*, f. 60.

²⁴ John T. Rourke, *International Politics on the World Stage*, Eighth Edition, USA: “Mc Graw-Hill / Dushkin”, 2001, f. 132.

²⁵ *Po aty*, f. 133.

²⁶ *Po aty*.

kundër të huajve²⁷. Në memorandumin e datës 13 qershor 1878 thuhet se: “Dhe pse me fe të ndryshme, shqiptari, qoftë katolik, ortodoks ose mysliman e urren si sundimin turk, ashtu dhe çdo sundim të huaj”.

“... Shqipëria, nuk mund t’i bashkohet Greqisë; ndryshime të thella kombësie, gjuhe, dokesh dhe kulture e bëjnë të pamundur bashkimin; Shqipëria nuk do ta durojë kurrë sundimin sllav, qoftë kur ai vjen nga kufijtë e Bullgarisë, qoftë kur vjen nga Mali i Zi”²⁸. Burim tjetër ishte origjina. Kjo dëshmohej nga promemoria (22 tetor 1878) që Pashko Vasa i dha kontit Zichy, ambasadorit të Austor-Hungarisë në Stamboll në vizitën që i bëri këtij të fundit. Promemoria thoshte: Origjina e tij pellazge (popullit shqiptar – S. Gj.) nuk i mohohet kurrë. Është edhe sot ai që ka qenë 40 shekuj më parë, populli i përmendur në këngët e Homerit. As fetë që ka ndërruar, as sundimet që ka ndërruar nuk kanë mundur të ndryshojnë mënyrën e jetesës së tij. Është ngulur në të shkuarën me gjithë fuqinë e karakterit të vet duke mbetur i lidhur me të, ndonëse kanë kaluar 40 shekuj mbi kryet e tij²⁹. Si e perceptuan populli dhe udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit vetveten? Shqiptarët e perceptuan veten në mënyrë të ndryshme nga sllavët, si për nga raca, tipi, gjuha, karakteri, zakonet e traditat³⁰. Mendoj se shqiptarët e përfytyruan vetveten sipas hipotezës që pohon Hobsbaum-i se çdo grup njerëzor me madhësi të konsiderueshme, pjesëtarët e të cilit besojnë se përbëjnë një “komb” trajtohet si i tillë³¹. Ndërsa intelektualët e shihnin konceptin e kombit sipas botëkuptimit që ky nocion kishte në epokën e Revolucioneve, se ai duhet të ishte “një dhe i pandashëm”³². Natyra që iu dha lëvizjes kombëtare dhe më konkretisht Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte ajo që kjo lëvizje duhej të ishte për *unifikimin* apo ekspansionin e kombit³³. Autonomia brenda shtetit osman dukej të ishte garancia më e mirë e sigurisë së tyre kombëtare³⁴. Pas daljes në shtyp të peticionit, gazeta Tercüman-i Hakikat nënvizoi se nuk ka pasur asnjë përmendje të një “administratë autonome”. Në prill gazeta njoftoi se Abdyl dhe Mehmet Ali Vrioni kishin udhëtuar si delegatë për në Romë, këtë herë për të paraqitur një çështje për një autonomi shqiptare. Ky informacion doli në fillim në një gazetë italiane. Çështja e autonomisë ishte një çështje shumë delikate brenda perandorisë dhe shqiptarët u treguan të mençur për të vepruar me maturi në këtë drejtim³⁵. Koncepti i komb-shtetit

²⁷ E. Hobsbaum, *vep. e përm.*, f. 91.

²⁸ Sh. Ballvora, *art. i cit.*, f. 10.

²⁹ Xhafer Belegu, *vep. e përm.*, f. 60.

³⁰ *Po aty*, f. 101.

³¹ E. Hobsbaum, *vep. e përm.*, f. 8.

³² *Po aty*, f. 18.

³³ *Po aty*, f. 33.

³⁴ Charles & B. Jelavich, *vep. e përm.*, f. 206.

³⁵ G. Gawrych, *vep. e përm.*, f. 86.

pësoi një evoluim të mëtejshëm në punimet e kuvendit të Gjirokastrës. Në këtë kuvend u shfaqën tipare të reja të konceptit të shtetit, krijimi i një qeverie të përkohshme, si dhe pajisja e vendit me kushtetutë. Gjithashtu këtu jo vetëm që shpallet, por edhe kërkohet si cilësi e kushtëzuar që duhet të kenë nëpunësit, të ishin shqiptarë. Përveç kombësisë shqiptare nuk vihet asnjë kërkesë tjetër, duke u thënë se nuk do të bëhet asnjë dallim fetar³⁶. Kërkesa për krijimin e një qeverie provizore është shprehje konkrete e së drejtës së shqiptarëve për të institucionalizuar qenien e tyre si komb në kuadrin e një shteti të identifikuar qartë. Humbja e Ulqinit ngjalli zemërim te shqiptarët, të cilët i dhanë një intensitet edhe më të madh përpjekjeve të tyre për autonominë e Shqipërisë. Në qershor 1880, në sarajin osman mbërritën shumë telegrame që njoftonin për kërkesat e shqiptarëve mbi bazën e vendimit që kishte marrë Lidhja e Prizrenit për autonominë e Shqipërisë³⁷.

Merita e hartuesve të programit të Lidhjes qëndron në faktin se për shkak të pozitës që ata zotëronin, duke shërbyer në detyra të larta shtetërore osmane kishin aftësinë ta perceptonin drejt konceptin e kombit³⁸. Duhet të theksojmë se ecuria e procesit të ndërtimit të kombeve ishte tej mase e gjatë dhe eksperimentale. Gjithsesi autonomia për kombin shqiptar në rast se do të realizohej edhe pse ishte një masë alternative në lidhje me pavarësinë kombëtare, ishte një hap paraprak që do të çonte drejt pavarësisë³⁹. Ky procesi i formimit të komb-shtetit ndeshi në probleme të ndryshme, pozicionet e kundërta midis rrymave politike që ekzistonin brenda Lidhjes rreth mënyrës se si e konceptonin zhvillimin e kombit dhe të shtetit. Një vështirësi tjetër ishte pamundësia për të integruar në këtë vetëdije kombëtare pronarët e mëdhenj të tokës. Jo të gjithë shqiptarët kishin të njëjtat objektiva për të njëjtat çështje. Delegatët që vinin nga viset e Shqipërisë së Veriut, si njerëz shumë më larg çështjeve kombëtare, mbështesnin më tepër idenë e autonomisë që për ta do të thoshte falje nga taksat dhe nga shërbimi ushtarak. Ata më tepër sesa për idenë e një uniteti kombëtar dhe më në fund, të një pavarësie të plotë ishin për përqendrimin e pushtetit në duart e udhëheqësve lokalë⁴⁰. Qëndrimet e përfaqësuesve konservator të Lidhjes në Tetovë, Shkup, Prishtinë, Prizren, Gjakovë ndaj platformës së Lidhjes dhe ndaj veprimtarisë së saj u bënë pengesë për një sukses të plotë të realizimit të programit kombëtar. Përpunimi i konceptit të komb-shtetit gjatë Lidhjes Shqiptare pati si qëllim që të krijonte një komb “organik” dhe homogjen nga pikëpamja gjuhësore. Shndërrimin e një

³⁶ *Po aty*, f. 89.

³⁷ N. Bozborra, *vep. e përm.*, f. 179.

³⁸ *Po aty*, f. 184.

³⁹ Mark Mazower, *Ballkani Një histori e shkurtër*, Tiranë: “Skanderbeg boks”, 2003, f. 104.

⁴⁰ *Po aty*, f. 184.

etnie deri atëherë pasive në një bashkësi ento-politike aktive. Sigurimin e një atdheu të njohur botërisht me kufij të përcaktuar, duke kërkuar njëkohësisht dhe autonominë administrative⁴¹.

Koncepti i ideologëve për kombin dhe shtetin është primordialist⁴² alias naturalist, që e merr kombin si një entitet të dhënë, i cili nuk i nënshtrohet dhe nuk është produkt si pasojë e ndryshimeve të modernitetit. Elita intelektuale shfrytëzoi të gjitha mënyrat e komunikimit për të siguruar dhe krijuar një solidaritet unik njerëzor, etnik, kombëtar, kulturor dhe shqiptar. Ajo përdori aktivisht propagandën si mjetin e duhur për të komunikuar me efikasitet, për të bërë të mundur që ky ligjërimit të zinte vend në popull jo thjesht si kod për të ndërtuar psikologjinë e përbashkësisë socio-politike dhe etnike-kulturore. Qëllimi i saj ishte të përpiqej të formonte te kjo bashkësi njerëzish perceptimin e të qenit sovran si formacion shtetëror dhe se u takon e drejta të vetqeveriseshin si komb i lirë. Mënyrat që u përdorën ishin elementë të komunikimit të ligjërimit publik, si: gazetatat, memorandumet, përkujtesat, protestat, programet dhe kuvendet. A mund të arrihej dhe të bëhej më shumë nga çfarë u realizua? A mund të pritej që ata, shqiptarët të kapnin brenda vitit ose edhe një dhjetëvjeçari parimin e nacionalizmit, ndërlikimet e diplomacisë, etikën e artit bashkëkohor të qeverisjes? A mund të pritej që ata të braktisnin menjëherë zakonet dhe traditat e një lashtësie të largët dhe të ndiqnin një politikë të ndërlikuar në kundërshtim me instinktet e tyre? Tradita vdes me zor kudo në botë⁴³.

⁴¹ P. Misha, *art. i cit.*, f. 23.

⁴² Primordialistët i bëjnë thirrje detyrimeve emocionale dhe instiktive si shpjegimet themelore për mobilizimin kombëtar. Ata e datojnë në mënyrë tipike origjinën e ekzistencës së kombit prapa në epokat e largëta duke e trajtuar atë si dhënës emocional. Më gjerësisht *shih*: Steven E. Grosby, Athena S. Leoussi, *Nationalism and ethnosymbolism*, Great Britain: "Edinburgh University Press", 2006, f. 15-16; Rogers Brubaker, Mara Loveman, Peter Stamatov, "Ethnicity and cognition", në: *Theory and Society* 33, Netherlands: 2004, f. 31-64.

⁴³ J. Swire, *vep. e përm.*, f. 66.